



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr. 1436, datë 03.11. 2010

Për

“Disa ndryshime në VKD nr.1345, datë 23.07.2010 “ Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.11. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“ Disa ndryshime në VKD nr.1345,datë 23.07.2010 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

BAZA LIGJORE :

1. Neni 121 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (***K.Pr.A***);
2. Neni 31 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (***ligji nr. 9918***);

3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, e ndryshuar.
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbëre nga:

1. Shkresë nr. 3272, datë 2.11.2010 e sipërmarrësit Albfrut sh.p.k “Ankese drejtuar AKEP”
 2. Shkresë nr.3243, datë 28.10.2010 e sipërmarresit ABCom sh.p.k “Paraqitja e mosmarrëveshjeve midis Abcom dhe AMC për tarifën e terminimit të trafikut ndërkombetar të tranzituar”
 3. Shkresë nr. 3247, datë 29.10.2010 e sipërmarrësit Infotelecom “Kërkesë për ndërhyrje administrative për zgjidhje mosmarrëveshjeje ndërmjet Infotelecom dhe AMC për moslidhje MI-se”,
 4. Shkresë nr.5447/2, datë 29.10.2010 e sipërmarrësit AMC sh.a për dijeninë e AKEP drejtuar Albtelecom “Përgjigje letrës tuaj nr. 4837/1, datë 25.10.2010 mbi tarifën e terminimit në rrjetin e AMC për thirrjet ndërkombëtare të tranzituara”,
 5. Shkresë nr.2297/27, datë 29.10.2010 e sipërmarrësit Albtelecom “Kërkohet ndërhyrja e AKEP në kuadër të kërkesave të Albtelecom drejtuar AKEP në lidhje me sjelljet abuzive të AMC”;
 6. Shkresë nr. 3264, datë 01.11.2010 e sipërmarrësit Albtelecom “Mbi ndërprerjen në mënyre të njëanshme nga ana e AMC sh.a dhe Vodafone Albania të shërbimit të terminimit të trafikut hyrës ndërkombetar në rrjetet AMC dhe Vodafone”:
- si dhe,
7. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe provat e reja;
 8. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I.** Me Vendimin nr. 1345, datë 23.07.2010 Këshilli Drejtues i AKEP ka shqyrtuar ankimin administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarresit AMC sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

Me Vendimin e sipërcituar ndër të tjera KD ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesën ankimore të AMC sha duke e shoqëruar vullnetin administrativ me ndryshime konkrete në VKD nr. 1210, datë 31.03.2010.

- II.** Në referencë me faktet e paraqitura prej palëve në shkresat e mësipër cituara nëpërmjet ankimeve administrative të tyre:

1. Sipërmarrësi AMC tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare edhe pse në terma komerciale nuk e ka negociuar atë me sipërmarrësit e interesuar në mënyrë transparente duke dhënë shpjegime dhe argumenta për nivelin e saj, me qëllim që të vërtetojë se është një tarifë e arsyeshme, e orientuar drejt kostos, jo abusive, konkurruese dhe e pranueshme nga palët e interesuara gjithashtu brënda interesit të tyre të arsyeshëm komercial, detyrim ky që buron nga pika 1 e nenit 53 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku kërkohet që *“Në përcaktimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, sipërmarrësit duhet të synojnë orientimin e tarifave drejt kostos dhe në çdo rast sipërmarrësit duhet të shmangin përdorimin e tarifave abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurruese”*;
 2. Oferta e paraqitur nga AMC lidhur me tarifimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në vlerën 0.16 €/minute është shumë më e lartë se niveli i tarifës mesatare prej 0.067 €/minute të vendeve të BE, publikuar në Raportin e 15-te të Implementimit, duke cënuar në këtë mënyrë përcaktimin ligjor të parashikuar në shkronjën c) të nenit 8 të ligjit nr. 9918.
- III.** Sipërmarrësi AMC duke qënë në kushtet e mospranimit nga ana e sipërmarrësit Albtelecom si dhe sipërmarrësit e tjerë respektivisht të cituar në shkesat më sipër, të kësaj tarife të imponuar prej tyre dhe jo të negociuar, në mënyrë të menjëhershme, pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 1345 datë 23.07. 2010 të KD të AKEP më datë 01.11.2010 lidhur me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, pa pritur që AKEP të dalë me vendimin përkatës kundrejt ankimeve të paraqitura nga sipërmarrësit Albtelecom dhe sipërmarrësit e sipercituar, veçoi në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare, me ndërprerjen e ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ndaj këtyre sipërmarrësve, duke cënuar rëndë në këtë mënyrë, detyrimet e përcaktuara nga AKEP me vendimet Nr. 1210, datë 31.03.2010 dhe Nr. 1345, datë 23.07.2010 për aksesin dhe interkoneksionin në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 9918.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

1. Duke çmuar se sipërmarrësi me FNT - AMC nuk arriti të administrojë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme heqjen e masës rregullore për rregullimin *ex-ante* të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe përcaktimin e saj nëpërmjet negocimit në terma komerciale të pranueshme në mënyrë të dyanshme, si dhe nga natyra e mosmarreshjeve të depozituara së fundmi në AKEP lidhur ngushtësisht me aplikimin e tarifave për thirrjet hyrese ndërkombëtare ;
2. Duke patur parasysh detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 49, pikën 2 dhe 3 të nenit 53 dhe 55 të ligjit nr. 9918, në zbatim të kompetencave e përcaktuara në ligj nr. 9918,
 - Si dhe,
3. Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Në VKD nr. 1345, datë 23.07.2010 “ Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, germa b) ii e pikës 2 e pjesës “Vendosi” të ndryshojë dhe të bëhet si më poshte vijon:
 - 1.1 “Tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të Interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetin AMC janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP”.
“Në perputhje me nenin 57, pika 1 germa ‘a’:
Tarifa maksimale e terminimit të thirrjeve të referuar në pikën 1.1 më sipër në rrjetin AMC , të jetë 10.50 lek/minute dhe tarifë 0.31 lek/për thirrje
Tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare.”
2. Në VKD nr. 1345, datë 23.07.2010, germa c) e pikës 2, shfuqizohet.
3. Të gjitha përcaktimet e tjera të VKD nr, 1345, datë 23.07.2010, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI** .
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**